



M. 32 Prot
Dt: 07.01.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr.861/I prot.

Shkodër, më 30.12.2024


Lënda: Mbi Vendimin Nr. 85, datë 23.12.2024 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave funksionale të ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin”, neni 8, shkronja “a”, të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut” si dhe aneksin I “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut”, të ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetqeverisjes vendore”, neni 33, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 23, datë 30.07.2018 “Per procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të NJQV”, të Udhëzimit Plotësues të MFE nr. 3, datë 28.02.2024 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027”, të Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 05.07.2024 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027”, të shkresës së Këshillit të Bashkiak nr. 7622 prot datë 27.12.24 dokumentacioni i mbledhjes së Këshillit Bashkiak”, shqyrtoi VKB Nr. 85, datë 23.12.2024 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës “Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm 2026-2028”.
Për sa trajtuar, Prefekti u njoh dhe ju autorizon të procedoni.
Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI

Majlinda ANGONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 85, datë 23.12.2024

**“PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË PËRGATITJES SË PROGRAMIT
BUXHETOR AFATMESEM 2026-2028 DHE BUXHETIT VJETOR 2026 TË
BASHKISË VAU DEJËS”**

Këshilli Bashkiak Vau Dejes në mbledhjen e tij të datës 23.12.2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të neneve 54 shkronja “k” të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, nenit 33 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr. 9936 date 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, ligjit nr. 10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar, udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesem të NJQV”, udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 “Mbi procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, dhe relacionit të administratës së Bashkisë Vau Dejes, Këshilli Bashkiak:

VENDOSI:

1. Miratimin e Kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesem 2026-2028 dhe buxhetit vjetor 2026 të Bashkisë Vau Dejes, sipas lidhjes nr. 1, bashkangjitur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Efektet e këtij vendimi janë nga data 01.01.2025 deri 31.12.2025.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55 pika 6 të ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore i ndryshuar”).

Kryetari Këshillit
Ervis Shimaj

Miratuar me 20 vota

Vota Pro 20

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me 27.12.2024



Sekretari Këshillit
Ardian Celepija



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS



Nr. 7438 Prot

Vau Dejës, më 17.12.2024

Lënda: **Kërkesë për shqyrtim dhe miratim projekt-vendimi.**

KËSHILLIT BASHKIAK VAU DEJËS

Të nderuar këshilltarë,

Bashkëlidhur po ju dërgojmë për shqyrtim dhe miratim projekt-vendimin për "*Për miratimin e Kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe buxhetit vjetor 2026 të Bahkisë Vau Dejës*", për Bashkinë Vau Dejës"

Duke ju uruar punë të mbarë!

KRYETAR

Kristian SHKRELI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS

Nr. ____ Prot

Vau Dejës, më ____ . ____ .2024

PROJEKT - VENDIM

Nr. 15, datë 17.12.2024

**“PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË PËRGATITJES SË PROGRAMIT
BUXHETOR AFATMESEM 2026-2028 DHE BUXHETIT VJETOR 2026 TË
BASHKISË VAU DEJËS”**

Këshilli Bashkiak Vau Dejes në mbledhjen e tij të datës ____ . ____ .2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të neneve 54 shkronja “k” të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, nenit 33 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, ligjit nr. 10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar, udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesem të NJQV”, udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 “Mbi procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, dhe relacionit të administratës së Bashkisë Vau Dejes,

VENDOSI:

1. Miratimin e Kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesem 2026-2028 dhe buxhetit vjetor 2026 të Bashkisë Vau Dejes, sipas lidhjes nr. 1, bashkangjitur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Kristian SHKRELI





Lidhja nr.1

KALENDARI I PËRGATITJES SË PROJEKT PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM 2026-2028 DHE BUXHETIT VJETOR 2026

Kalendari PBA & buxhetit vjetor

- Përgatitet nga kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe i propozohet më tej Këshillit të njësisë;
- Miratohet nga këshilli i njësisë (brenda 31.12. viti 2024);
- Hyn në fuqi dhe shpërndahet te të gjitha njësitë shpenzuese nga kryetari i njësisë (1.01.2025).

Vlerësimet dhe parashikimet e të ardhurave dhe shpenzimeve

- Kryetari paraqet për shqyrtim dhe miratim në këshill (brenda 31.01. viti 2025);
- Këshilli miraton raportin e vlerësimeve (1.03. viti 2025).

Tavanet e shpenzimeve të PBA në nivel programi

- Kryetari i njësisë propozon tavanet përgatitore për miratim në këshill (1.03. viti 2025);
- Këshilli miraton tavanet përgatitore (15.03. viti 2025);
- Kryetari i njësisë miraton udhëzimin për përgatitjen e buxhetit (5 ditë nga miratimi i taveve);
- Udhëzimi shpërndahet te njësitë shpenzuese (5 ditë nga miratimi i taveve / 20.03. viti 2025);
- Tavanet përfundimtare paraqiten nga kryetari i njësisë në këshill (korrik viti 2025);
- Këshilli miraton tavanet përfundimtare (20.07.viti 2025);
- Kryetari i njësisë nxjerr udhëzimin plotësues për përgatitjen e buxhetit të njësisë dhe e shpërndan te të gjitha njësitë shpenzuese (5 ditë nga miratimi i taveve përfundimtare / 25.07. viti 2025).

Kërkesat sipas taveve buxhetore

- Njësitë shpenzuese paraqesin kërkesat brenda taveve përgatitore të Njësia e Menaxhimit të Programeve (prill.viti t) dhe japin argumente për fonde / tavane shtesë;
- Njësitë shpenzuese paraqesin kërkesat brenda taveve përfundimtare (1.08. viti 2025).

PBA & Buxheti vjetor

- Kryetari i njësisë përgatit dokumentin I të PBA viti t+1, t+2, t+3 (30.05.2025)
- Kryetari i njësisë dërgon MFE PBA (1.06. viti 2025);
- MFE-ja dërgon opinionionin e saj mbi PBA-në te njësia vendore (20.06. viti 2025);
- Kryetari i njësisë vendore dërgon PBA-në së bashku me opinionin e MFE-së për miratim në Këshill (21.06. viti 2025);
- Këshilli i njësisë vendore miraton dokumentin e parë të PBA-së (30.06. viti 2025);
- Kryetari publikon PBA / dokumentin I (5.07 viti 2025);
- MFE-ja nxjerr udhëzimin plotësues për rishikimin e PBA-së (10. korrik viti 2025);
- Njësia rishikon PBA-së (korrik - gusht viti 2025);
- Njësia organizon takime konsultuese (1-15.09. viti 2025);
- Njësia dërgon PBA-në e rishikuar te MFE-ja 15.09.2025
- MFE-ja zhvillon seanca konsultimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore (5.10.2025);
- MFE-ja dërgon opinionin përfundimtar sipas rastit te njësia vendore (20.10.2025);
- Kryetari i bashkisë paraqet për miratim në Këshill PBA-në dhe buxhetin vjetor përfundimtar (30.11.2025);
- Këshilli miraton PBA-në dhe buxhetin vjetor (25.12.2025);
- Kryetari i njësisë publikon PBA-në dhe buxhetin vjetor dhe materialet shoqëruese (31.12.2025).

KRYETAR

Kristian SHKRELI



SEKRET
BASHKIA VU-DEJ

Zv. Kryetar

Elvis Joci

Zv. Kryetar

Aleksandra Gjoni

Zv. Kryetar

Ervis Mollo

Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar

Elza Barce

Drejtoria Juridike e Prokurimeve, Integritit dhe Aseteve

Marinka Duda

Drejtoria e Burimeve Njerëzore

Përmira Jari

Policia Bashkiake

Jon Gjokan

Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Kadastrës dhe Investimeve Publike

Ane Shurdha

Drejtoria e menaxhimit të Pyjeve, Inspektimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit

Drejtoria e Shërbimeve Publike, Bujqësisë, Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Veterinarisë

Leorenc Petroj

Drejtoria e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë, Sportit dhe Zhvillimit të Turizmit

Devis Peci

Drejtoria e Mbrojtjes, Përfshirjes dhe Strehimit Social

Ridvan Luzaku

Drejtoria e Informimit Publik, Medias, dhe It

Drejtoria e Mbrojtjes dhe Emergjencave Civile

Emrol Zogani